

Përfundimtar

**Rezolutë e Konferencës Evropiane të Autoriteteve  
të Mbrojtjes së të Dhënave**

**Limasol, 27-28 prill 2017**

**Rezolutë mbi modernizimin e Konventës për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi  
Automatik i të Dhënave Personale [ETS nr. 108, që këtej e tutje 'Konventa 108']**

Autoritetet Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave, të mbledhura në Konferencën e tyre Pranverore të 2017-ës deklarojnë:

Me keqardhje se procedura për modernizimin e Konventës 108, e cila nisi në 2011-ën dhe është ndjekur me shumë interes prej tyre, është vonuar shumë dhe nxit të gjitha palët që të arrijnë marrëveshje,

Kuptojnë se çështjet e pazgjidhura kanë të bëjnë me të drejtën për votim të Bashkimit Evropian, përjashtimet në lidhje me sigurinë kombëtare, qarkullimet ndërkufitare të të dhënave dhe çështjen e hyrjes në fuqi të dispozitave të modernizuara,

Marrin parasysh domosdoshmërinë për të garantuar përputhshmëri me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së dhe Direktivën e BE-së, e cila zbaton rregullat e mbrojtjes së të dhënave në fushën e agjencive të zbatimit të ligjit, të cilat do të jetë plotësisht të zbatueshme në maj të 2018-ës,

Angazhohen për bashkëpunim të ngushtë ndërmjet autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave në zbatimin e këtyre normave të mbrojtjes së të dhënave, i cili është thelbësor për zbatimin e të drejtave të subjekteve në kuadër të praktikave ndërkufitare,

Rrjedhimisht, janë thellësisht të shqetësuar, se vonesa e mëtejshme e finalizimit të modernizimit, mund të krijojë vështirësi ligjore për zbatimin e këtyre instrumenteve ligjore të BE-së, gjë që do të ishte në dëm të individëve dhe autoriteteve rregullatore të përfshira,

Pohojnë se ekzistojnë mënyra të ndryshme për të finalizuar një Konventë të mbrojtjes së të dhënave të modernizuar, sikurse një protokoll ndryshimesh ose një Konventë e rishikuar,

Theksojnë se përpjekjet për të modernizuar Konventën 108, në asnjë mënyrë nuk duhet të rezultojnë në një nivel më të ulët mbrojtjeje se sa ai aktual,

- Shprehin mbështetjen e tyre të fuqishme për negociatat që po zhvillohen në Këshillin e Evropës dhe nxisin palët në negociata të bëjnë përpjekje të tjera, për të gjetur zgjidhje të përshtatshme në lidhje me çështjet e pazgjidhura, duke garantuar njëkohësisht nivel të lartë të mbrojtjes së të dhënave dhe të mundësojnë hyrjen në fuqi të Konventës së modernizuar sa më shpejt që të jetë e mundur, e shumta deri në maj 2018;
- I bëjnë thirrje qeverive të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian që të arrijnë një marrëveshje politike gjatë Sesionit të 127-të Ministror të Komitetit të Ministrave, i cili do të zhvillohet në Nikozia, datë 19 maj 2017, për të mundësuar finalizim të shpejtë të modernizimit.

Konferenca Pranverore e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave ngarkon organizatorin e Konferencës, t'ia paraqesë Rezolutën Presidencës Qipriote të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për Sesionin e 127-të Ministror të Komitetit të Ministrave.

**Resolution of the European Conference  
of Data Protection Authorities**

**Limassol, 27 – 28 April 2017**

**Resolution on the modernisation of the Convention for the Protection of  
Individuals with regard to Automatic Processing of Personal Data [ETS No. 108,  
hereafter ‘Convention 108’]**

The European Data Protection Authorities, assembled in their Spring Conference of 2017 hereby:

Regret that the procedure for the modernisation of Convention 108, which started in 2011 and has been followed with great interest by them, has been considerably delayed and encourages all parties to reach resolutions,

Understand that the outstanding issues concern the voting rights of the European Union, national security exceptions, transborder data flows and the question of entry into force of the modernised provisions,

Take note of the need to ensure consistency with the EU General Data Protection Regulation and the EU Directive applying data protection rules in the area of law enforcement, both which will be fully applicable in May 2018,

Commit to close cooperation between data protection authorities in the application of these data protection rules, which is essential to enforce data subjects’ rights in cross-border cases,

Therefore are deeply concerned that further delay of the finalisation of the modernisation could create legal difficulties in relation to the application of those EU legal instruments, which would ultimately be detrimental both to individuals and regulators concerned,

Recognise that several ways of delivering a modern data protection Convention exist, such as an amending protocol or a revised Convention,

Stress that the effort to modernise Convention 108 should in no way result to lower the level of the protection currently afforded,

- Express their strong support for the negotiations taking place at the Council of Europe and encourage the negotiating parties to renew their efforts to find appropriate final solutions to the outstanding issues whilst ensuring a high level of data protection, and to enable the modernised Convention to enter into force as soon as possible and, in any case, in May 2018 at the latest;
- Call upon the governments of Council of Europe Member States and the European Union to reach a political agreement at the 127<sup>th</sup> Ministerial Session of the Committee of Ministers to be held in Nicosia on 19 May 2017, enabling a rapid finalisation of the modernisation.

The Spring Conference of Data Protection Authorities mandates the host of the Conference to submit this Resolution to the Cyprus Chairmanship of the Committee of Ministers of the Council of Europe, in view of the 127<sup>th</sup> Ministerial Session of the Committee of Ministers.